



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 180, Datë 27.07.2020

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT

Në mbështetje të nenit 143 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë; nenit 9 të Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese; nenit 189, pika 1, gërma c të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë”, i ndryshuar; nenit 8 të Rregullores së KLP-së “Për veprimtarinë jashtë funksionit të prokurorëve” Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit, konkretisht angazhimin si ekspert, pranë Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, për prokuroren Znj. Enkeleda Millonai, në masën jo më shumë se 80 minuta në ditë, për dy ditë, në trajnimin me temë “Çështjet gjyqësore në fushën doganave. Veprat penale në fushën e doganave.” i cili do të zhvillohet brenda muajit korrik të vitit 2020;
2. Të njoftohen për këtë vendim znj. Enkeleda Millonai dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

